

# BROSHURË INFORMATIVE PËR PERSONAT PA SHTETËSI NË KOSOVË

---

## NJIHNI TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E JUAJA



Shtypja e broshurës u mbështet nga Zyra e Shefit të Misionit të Komësariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) në Prishtinë. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNHCR-së.

# PËRKUFIZIMET

## E TERMAVE THEMELORE TË PËRDORURA NË BROSHURË

### PERSONI PA SHTETËSI

personi i cili nuk konsiderohet shtetas i asnjë shteti në kuadër të fushëveprimit të ligjeve të tij.

### SDP

PROCEDURA E PËRCAKTIMIT TË STATUSIT PA SHTETËSI (SDP) është një proces administrativ përmes të cilit një individ mund të aplikojë për statusin ligjor si person pa shtetësi. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM) – Divizioni i Shtetësisë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) është autoriteti përgjegjës.

### VENDIMI

VENDIMI PËR STATUSIN PA SHTETËSI jepet nga DSHAM dhe mundëson proces të mëtejshëm me Divizionin për të Huaj (DH) pranë DSHAM-së në dhënien e lejes së qëndrimit.

### QASJA NË TË DREJTA

autorizim i lëshuar nga autoritetet që lejon një të huaj të qëndrojë ligjërisht në territor, i lëshuar nga DH.

### NATYRALIZIMI

është procesi ligjor i një personi të huaj për të marrë shtetësinë e një vendi në të cilin nuk ka lindur.

### ACCESS TO RIGHTS

mundësohet pas njohjes së statusit ligjor. Të drejtat e personave me status pa shtetësi përcaktohen në përputhje me Ligjin për Shtetësinë, Ligjin për të Huajt dhe Rregulloren për Integrimin e të Huajve dhe akte të tjera legjislative që kanë të bëjnë me fushat specifike.

### DOKUMENTET E GJENDJES CIVILE

janë të dhëna të ngjarjeve të jetës që mbahen nën autoritetin qeveritar, duke përfshirë certifikatat e lindjes, certifikatat e martesës, certifikatat e vdekjes dhe çdo certifikatë tjetër të lidhur ngushtë me ngjarjet e jetës.

### DRPRIH

DEPARTAMENTI PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE (DRPRIH) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) është përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të integritit të huajve.

# HYRJE

Qëllimi i kësaj  
broshure është

TË OFROJ  
INFORMACIONIN

e nevojshëm për të drejtat  
dhe shërbimet për personat  
me status pashtetësi, dhe  
anëtarët e familjes së tyre  
nëse gëzojnë të njëjtin status

Për më tepër, kjo broshurë do të ofrojë  
informacione të segmentuara për të drejtat e  
ndryshme dhe mënyrën e qasjes në shërbime së  
bashku me informacionin e detajuar për zyrtarët  
përkatës komunal/personat kontaktues.

Ju mund t'u drejtoheni  
autoriteteve  
dhe organizatave  
përkatëse, në çdo kohë,  
për mbështetje  
dhe ndihmë.



# KENI TË DREJTË NË

- ☒ Informacion
- ☒ Qëndrimin në territor
- ☒ Dokumentet e gjendjes civile
- ☒ Dokument të identitetit
- ☒ Dokument udhëtimi
- ☒ Natyralizimi
- ☒ Mundësi punësimi dhe trajnimi
- ☒ Kurset e gjuhës
- ☒ Kujdesit shëndetësor
- ☒ Arsimit
- ☒ Liria e mendimit dhe besimit fetar
- ☒ Bashkim familjarë
- ☒ Qasje në drejtësi dhe ndihmë juridike falas
- ☒ Të drejtën në pronësi
- ☒ Të drejtën në asocim

# INFORMACION

Ju keni të drejtë të merrni informacionin për të drejtat dhe detyrimet tuaja, si dhe procedurat që ju shqetësojnë, në gjuhën që ju e kuptoni

Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve (DRPRIH) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) është përgjegjës për informimin e personave pashtetësi për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre gjatë procesit të integritimit, në përputhje me Rregulloren për Integrimin e të Huajve, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=21006>.

Ky informacion është i disponueshëm në gjuhën serbe dhe shqipe, si dhe në një gjuhë që kuptojnë personat pashtetësi. Të gjithë personat pa shtetësi u ofrohen informacioneve bazë në lidhje me integrimin menjëherë pas marrjes së statusit ligjor në Kosovë. Ju lutemi referojuni faqes së mëposhtme të ndihmës për burime shtesë - <https://help.crpkosovo.org/English/integration.html>.

## QËNDRIMIN NË TERRITOR

Ju keni të drejtë të qëndroni në Kosovë

Me marrjen e statusit ligjor të personit pa shtetësi, ju është dhënë baza ligjore për qëndrimin në territor. Me marrjen e statusit, ju jeni të detyruar të respektoni legjislacionin e aplikueshëm njësoj si qytetarët. Ju nuk do të përfshihen në asnjë aktivitet që mund të jetë në kundërshtim me rregullat dhe rendin.



# DOKUMENTET E GJENDJES CIVILE

Faktet e lindjes dhe vdekjes mund t'i regjistroni në regjistrat komunalë të gjendjes civile të vendbanimit tuaj

Në përputhje me Ligjin për Gjendjen Civile, Ligjin për Shtetësinë dhe aktet nënligjore përkatëse, Zyrat Komunale të Gjendjes Civile në komunën tuaj përkatëse të vendbanimit do t'ju ofrojnë të gjitha shërbimet në lidhje me regjistrimin e lindjes dhe vdekjes, përveç të drejtave të martesës dhe të shtetësisë.

## DOKUMENT TË IDENTITETIT

Pasi pajiseni me status të personit pa shtetësi, ju keni të drejtë të aplikoni dhe të merrni një letërnjoftim për qëndrim të përkohshëm

Të pajisur me vendim të personit me status pa shtetësi, ju do të aplikoni për leje qëndrim të përkohshëm (letërnjoftim). Çdo person aplikon personalisht në Divizionin e të Huajve në kuadër të DSHAM-it në MPB në Prishtinë. Për fëmijët pa shtetësi, deri në 18 vjeç, aplikimi për lëshimin e letërnjoftimit bëhet nga përfaqësuesi ligjor ose kujdestari ligjor i tij/saj.

Vlefshmëria e letërnjoftimit është një (1) vit, me mundësi ripërtirje. Kërkesa për vazhdimin e letërnjoftimit për qëndrim të përkohshëm është e ngjashme me kërkesën fillestare, me kushtin e aplikimit personal shtatë (7) ditë pune para skadimit të saj.

Pasi të lëshohet letërnjoftimi, do t'ju mundësohet gasja në të gjitha të drejtat e tjera.



# DOKUMENT UDHËTIMI

Ju keni të drejtën e një dokumenti udhëtimi për personat pashtetësi

Aplikimi për dokument udhëtimi për personin pa shtetësi dorëzohet personalisht në Divizionin e të Huajve në kuadër të DSHAM-së, MPB-së në Prishtinë.

## NATYRALIZIMI

Pesë vjet pas njohjes së statusit pa shtetësi në Kosovë, ju mund të aplikoni për natyralizim

Ju keni të drejtë të aplikoni për shtetësi të Kosovës në bazë të natyralizimit. Të drejtën për të aplikuar e gëzoni pas pesë (5) viteve të njëpasnjëshme qëndrimi të rregullt dhe të pandërprerë, duke filluar nga dita kur ju njihet statusi pa shtetësi.

## MUNDËSI PUNËSIMI DHE TRAJNIMI

Të jesh në gjendje të trajnohesh dhe të gjesh një punë është një vlerë e shtuar për integrimin tënd në shoqëri

I gjithë informacioni mbi mundësitë, kushtet dhe masat aktive të tregut është i disponueshëm në DRPRIH. Agjencia e Punësimit e Kosovës dhe Zyrat e Punësimit luajnë një rol jetik për t'ju lidhur me mundësitë e punësimit dhe aftësimit profesional, duke garantuar drejtësi dhe pa diskriminim. Trajnimet dhe kurset e aftësive profesionale ofrohen nga QAP-ja dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve të formimit profesional. Ju lutemi kontaktoni Zyrën e Punësimit në komunën tuaj të banimit dhe regjistrohuni. Agjencia e Punësimit, nëpërmjet zyrave të saj lokale, do t'ju ofrojë këshillim, profilizim dhe udhëzim duke ju mbështetur në gjetjen e mundësive të përshtatshme të tregut të punës.



# KURSET E GJUHËS TË OFRUARA NGA DRPRIH

Njohja e një  
gjuhe shtesë  
mundëson  
integrim më të  
lehtë me  
komunitetet në  
lokacionin e  
vendbanimit  
tuaj

MPB/DRPRIH, në bashkëpunim me institucionet përkatëse arsimore dhe organizatat , ofron kurse gjuhësore. Kurset e gjuhës janë të disponueshme në gjuhët zyrtare në nivelet A1 ose A2. Një vlerësim fillestar do të bëhet mbi njohuritë tuaja gjuhësore dhe do të vendoseni në nivelin adekuat të kursit të gjuhës. Njohja e gjuhës është një parakusht i rëndësishëm për natyralizim të suksesshëm në përputhje me afatet e përcaktuara kohore.

## KUJDESIT SHËNDETËSOR

Shëndeti juaj  
është thelbësor  
dhe shërbimet  
janë të  
disponueshme  
për të trajtuar çdo  
shqetësim tuajin

Të drejtën e qasjes në shërbime shëndetësore parësore, dytësore dhe terciare e kanë personat pa shtetësi në të njëjtat kushte si për të gjithë banorët në institucionet publike.

## ARSIMIM

Arsimimi është  
një rrugë drejt  
një të ardhmeje  
më të ndritshme

Të drejtën e qasjes në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në institucionet publike e kanë personat pashtetësi në të njëjtat kushte si për të gjithë qytetarët e vendit.

# LIRIA E MENDIMIT DHE BESIMIT FETAR

Ju mund ta praktikoni fenë tuaj lirisht pa diskriminim

Ju keni të drejtë të ushtroni dhe shprehni lirisht mendimin dhe besimin tuaj fetar pa diskriminim.

## BASHKIM FAMILJARË

Uniteti familjar, gurthemeli i të drejtave tuaja

Ju keni të drejtë të aplikoni për bashkim familjar në Kosovë sipas kushteve të parapara me Ligjin për të Huajt. Për të filluar procesin, ju duhet të paraqisni një kërkesë personalisht në Divizionin e të Huajve në kuadër të DSHAM-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Prishtinë.

## QASJE NË DREJTËSI DHE NDIHMË JURIDIKE FALAS

Të drejtat tuaja janë të rëndësishme. Qasja në ndihmë juridike dhe drejtësi është e garantuar

Ju keni të drejtë për ndihmë juridike falas nëse nuk keni mjete të mjaftueshme financiare për të mbuluar shpenzimet. Ju mund të ndihmoheni në hartimin e kërkesave dhe ankesave dhe të përfaqësoheni para organeve administrative dhe gjykatave kompetente. Ndihma juridike falas për ju ofrohet nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas dhe CRP/K.



## TË DREJTËN NË PRONËSI

Të kesh një pronë  
është vetëm një  
hap tjetër drejt  
integritimit efektiv

Ju keni të drejtën të posedoni pasuri të  
luajtshme dhe të paluajtshme në të njëjtat  
kushte si personat e huaj.

## TË DREJTËN NË ASOCIM

Ju mund të  
bashkoheni dhe  
të përfitoni nga  
organizatat  
profesionale

Ju keni të drejtë të bashkoheni ose të bëheni  
anëtar i një organizate që përfaqëson  
punonjësit, punëdhënësit ose profesione të  
tjera dhe të merrni përfitime nga ato  
organizata.

# OBLIGIMET TUAJA NË KOSOVË

Me njohjen e statusit pa shtetësi, ju duhet t'i përmbaheni rendit ligjor në fuqi, si dhe të respektoni masat e marra për ruajtjen e rendit publik.

## MBËSHTETJE PËR INTEGRIM

Ju keni të drejtë për mbështetje me masat specifike të integrimit pranë DRPRIH-së, e cila do të vlerësojë kërkesat individuale dhe do të zhvillojë një plan të personalizuar integrimi.

Për të filluar procesin, ju duhet të kontaktoni Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në komunën përkatëse të vendbanimit.

DRPRIH do të zbatojë planin e zhvilluar të personalizuar të integrimit në koordinim të ngushtë me institucionet relevante qendrore dhe departamentet përkatëse komunale në komunën e vendbanimit tuaj.





## **DOKUMENTE** TË RËNDËSISHME PËR TË KONSULTUAR



Ligji për Shtetësinë, në dispozicion në:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8873>



Ligji për të Huajt, në dispozicion në:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>



Rregullore për Integrimin e të Huajve, në dispozicion në:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21006>



Ligji për Gjendjen Civile, në dispozicion në:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2743>

# KË MUND TA **KONTAKTONI**?

## Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM)/MPB

Tel: + 383 38 200 19 596

Adresa: Rr. "Luan Haradinaj" p.n. Prishtinë

## Divizioni për të Huaj-DSHAM/MPB

Tel: +383 38 200 19 027

Adresa: Rr. "Luan Haradinaj" p.n. Prishtinë

## Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve (DRPRIH)/MPB

Tel: +383 (0) 38 521 266

Centrex: +383 (0) 200 76 731

Adresa: Rr. "Luan Haradinaj" p.n. Prishtinë

<https://mpb.rks-gov.net/>

## Agjensioni për Ndihmë Juridike Falas

Tel: 038 200 18 941; 038 200 18 950

Emaili: [info.anjf@rks-gov.net](mailto:info.anjf@rks-gov.net)

Zyra në Prishtinë: Rr. "Zenel Salihu" nr. 30

## UNHCR Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë

Tel: + 383 38 241 509, 0800 22 888

Emaili: [OCMPristina@unhcr.org](mailto:OCMPristina@unhcr.org)


Adresa: Rr. "Lorenc Antoni" Nr. 26, Prishtinë

## Programi për të Drejtat Civile Kosovë (CRP/K)

Tel: +383 (0) 38 243- 610/611

Emaili: [crp@crpkosovo.org](mailto:crp@crpkosovo.org)

Adresa: Rr. "Lorenc Antoni" Nr. 15, Prishtinë





---

**NJIHNI TË  
DREJTAT DHE  
OBLIGIMET  
E JUAJA**

---





MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
MINISTARSTVO UNUTRASNIJH POSLOVA  
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS



**CRP/K**

PROGRAMI PËR TË DREJTAT CIVILE KOSOVË  
CIVIL RIGHTS PROGRAM KOSOVO  
PROGRAM GRAĐANSKIH PRAVA KOSOVA

## BROSHURË INFORMATIVE PËR PERSONAT PA SHTETËSI NË KOSOVË

### NJIHNI TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E JUAJA!

## NA KONTAKTONI



+383 38 243 610



[crp@crpkosovo.org](mailto:crp@crpkosovo.org)



[www.crpkosovo.org](http://www.crpkosovo.org)  
[help.crpkosovo.org/statelessness](http://help.crpkosovo.org/statelessness)

